



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 421/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Naser Osmani kandidat për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Lipjan, paraqitur kundër Vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Naser Osmani kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Lipjan .

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 14:05 nga Naser Osmani kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit LDK-AKR me seli në Lipjan, në ankesën e parashtruar, kërkon që ta bëjë rinumërimin në vendvotimin me numër 1301E/02R, për shkak të dyshimeve lidhur me jo saktësin e numërimit të votave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, ankuesi me asnjë provë nuk ka argumentuar parregullsitë e pretenduara. Po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar .Parashtrimet në ankesë nuk paraqet bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore për ankuesin .

Sipas vlerësimit të Paneli ankesa e ankuesit nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmime

konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.421/2017 më datën 01.07.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*